



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. prot 19817

Tiranë 3/10/2016

NJOFTIM

Bazuar në ligjin Nr.139/2015. "Për Vetëqeverisjen Vendore". neni 53. njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak. ditën e **premtë, datë 07.10.2016, ora 11:00**, në sallën e Këshillit Bashkiak, me rendin e ditës si vijon:

1. P/Vendim për "Trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë".
2. P/Vendim për "Miratimin në parim të listës së qytetarëve përfitues dhe vlerës së Grantit të Menjëhershëm për banesat me kosto të ulët".
3. P/Vendim për "Programin e Nxitjes së Punësimit në ndihmë të krijimit të Biznesit Social Rinor".
4. P/Vendim për "Disa ndryshime në nivelin e pagave dhe numrin e punonjësve të Institucioneve të varësisë".
5. P/Vendim për "Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.38, datë 23.05.2016 "Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit".
6. P/Vendim për "Miratimin për kalimin në përdorim pa kundërshtim për shoqërinë "Eco Tirana" sh.a", të pasurisë me nr. 4/165, me sipërfaqe totale 21685.00 m2 me emërtimin "Parku i Transportit Tiranë" dhe me vendndodhje në rr. Don Bosko, Tiranë, në pronësi të Bashkisë së Tiranës, për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve të shoqërisë "Eco Tirana" sh.a".
7. P/Vendim për "Shprehjen e pëlqimit për dhënien me qira të fushave të tenisit pranë shkollës 9- vjeçare "Dora D'Istria".
8. P/Vendim për "Miratimin e propozimit për dhënien me qira të fushës së sportit në fshatin Mëzez, Njësia Administrative Kashar, me nr.pasurie 191/3 me sipërfaqe totale 7680 m2".

9. P/Vendim për “Pajisjen me çertifikatë përdorimi të objekteve të ndërtuara në shkelje të kushteve të ndërtimit, të cilat nuk janë objekt i ligjit nr.9482, datë 3.4.2001 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (i ndryshuar)”.
10. P/Vendim për “Disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.2, datë 30.03.2009 mbi “Miratimin e Rregullores, për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Taksi në Qytetin e Tiranës” (i ndryshuar)”.
11. P/Vendim për “Një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016- 2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016 (i ndryshuar)””

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

- **Komisioni Juridik:**
Eridian Salianji (Kryetar), Fabian Topollari (zv/kryetar), Klotilda Bushka, Blerina Dorcaj, Agim Kraja, Kreshnik Çollaku, Akil Kraja.
Komisioni do të shqyrtojë pikën 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe do të mbledhet ditën e enjte, datë **06.10.2016, ora 12:00.**
- **Komisioni i Financës, Ekonomisë dhe Nxitjes së Sipërmarrjes:**
Kozeta Fino (Kryetar), Mateo Spaho (zv/kryetar), Aida Llazani, Elisa Spiropali, Ardit Çela, Suzana Guxholli, Reila Bozdo, Vjollca Braho.
Komisioni do të shqyrtojë pikat 2, 3, 4, 5, 11 dhe do të mbledhet ditën e enjte, datë **06.10.2016, ora 14:00.**
- **Komisioni i Strehimit dhe Çështjeve Sociale:**
Klotilda Bushka (kryetar), Merita Poni (zv/kryetar), Florian Pullazi, Endrit Brahimllari, Albina Nanaj, Besnik Aliaj, Ferdinand Shehu.
Komisioni do të shqyrtojë pikën 1, 2, 3, 11 dhe do të mbledhet ditën e enjte, datë **06.10.2016, ora 16:00.**
- **Komisioni i Shërbimeve Publike;**
Akil Kraja (kryetar), Luan Bregasi (zv/kryetar), Auran Xhani, Ira Vejsiu, Eriona Bixha, Ariana Çela, Kreuza Leka.
Komisioni do të shqyrtojë pikat 10, 11 dhe do të mbledhet ditën e enjte, datë **06.10.2016, ora 17:00.**
- **Komisioni për Politikat Rinore:**
Endrit Brahimllari (kryetar), Reila Bozdo (zv/kryetar), Maria Myridinas, Joleza Koka, Ira Vejsiu, Argyrina Jubani, Akil Kraja
Komisioni do të shqyrtojë pikën 3, 11 dhe do të mbledhet ditën e enjte, datë **06.10.2016, ora 18:00.**

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

